

MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
NR. 2194/10 PROT
DATE 167 2004



REPUBLICA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 462 , datë 9.7.2004

P Ë R

**LEJIMIN E ANTA, SHA-së, TË PËRDORË PROCEDURËN
“PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR PAGESËN E
KONSULENTËVE JURIDIKË TË PËRZGJEDHUR, PËR
PËRGATITJEN E ANALIZËS JURIDIKE TË MBULIMIT TË
GARANCISË POLITIKE TË RISKUT, TË KREDISË, QË DO TË
MERRET NGA BNP PARIBAS BANK, PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT TË MODERNIZIMIT TË TRAFIKUT AJROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Lejimin e Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror (ANTA), sha, që, për fondin limit prej 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) USD-sh, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me katër konsulentët juridikë: 1) Weil, Gotshal&Manges LLP në New York, honoraret e të cilit arrijnë shumën 400 000 USD; 2) Weil, Gotshal&Manges LLP në Bruksel, honoraret e të cilit arrijnë shumën 35 000 USD; 3) Studio Legale Tonucci në Shqipëri, honoraret e të cilit arrijnë shumën 100 000 USD; dhe 4) Thompson Coburn në Washington D.C., konsulent juridik i BNP Paribas, honoraret e të cilit arrijnë shumën 15 000 USD, të përzgjedhur nga US Exim Import Bank, për analizën

juridike të mbulimit të garancisë politike të riskut, të kredisë, që do të merret nga BNP Paribas Bank.

2. Ky fond të përballohet nga të ardhurat e ANTA, sha-së.
3. Ngarkohet ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI



FATOS NANO

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE I TELEKOMUNIKACIONIT



SPARTAK POÇI

Nr.1974/1
DATË 15.7.2004

PRESIDENCËS
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE
TË TELEKOMUNIKACIONIT
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË FINANCEVE
ANGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
QENDRËS SË PUBLKIMEVE ZYRTARE

